

Në bazë të nenit 3, të Ligjit për mbrojtje nga pirja e duhanit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 36/95, 70/03, 29/04, 37/05, 79/07, 103/08, 140/08, 35/10, 100/11, 157/13 dhe 51/18) dhe nenit 27, paragrafit 1, pikës 6, të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore, Bordi i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 09.09.2019, e miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR MBROJTJE NGA PIRJA E DUHANIT, ALKOOLIT DHE SUBSTANCIVE NARKOTIKE NË HAPËSIRAT E UNIVERSITETIT**

### **I. Objekti i rregullimit**

#### **Neni 1**

Ndalohet pirja e duhanit në çdo ndërtesë të Universitetit dhe në çdo kohë. Shkeljet e kësaj dispozite (pirja e duhanit), do të raportohen te Zyra e burimeve njerëzore, nga ana e operatorëve të sigurimit, të cilët do të ndërmarrin aksion disiplinor dhe do t'i lajmërojnë autoritetet shtetërore. Pirja e duhanit është e lejuar vetëm në zonat e caktuara për prijje të duhanit që ndodhen jashtë çdo ndërtese, ku nuk ka rrezik sigurie.

#### **Neni 2**

Alkooli nuk është i lejuar në hapësirat e kampusit përveç në evenimente speciale të organizuara nga Zyra e rektorit dhe me autorizim të Sekretarit të përgjithshëm.

#### **Neni 3**

- (1) Universiteti ndalon shitjen, shpërndarjen, posedimin, ose përdorimin e substancave narkotike, ose substancave të tjera jo legale, si në hapësirat e kampusit(eve) universitar(e), ashtu edhe në të gjitha aktivitetet e tij.
- (2) Stafi i Universitetit dhe studentët, të cilët shesin, distribuojnë, konsumojnë, ose janë nën ndikimin e alkoolit, ose substancave narkotike trajtohen në pajtim me Rregulloren disiplinore. Vizitorët pritët që të sillen sipas kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 4**

Shërbimi i sigurimit të Universitetit e bën zbatimin e kësaj rregulloreje.

### **II. Dispozitat përfundimtare**

#### **Neni 5**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 01.10.2019.